

# PPP-të: Nga ambicia për investime te realiteti i mungesës së llogaridhënies

👤 Autori: Open Data Albania 📅 Date : 15 Tetor, 2025

Në vend që të shërbejnë si mjet për të rritur efikasitetin e shërbimeve publike, shumë prej PPP-ve të zbatuara gjatë dekadës së fundit janë shoqëruar me dyshime të thella dhe evidenca konkrete që tregojnë devijimin e tyre nga standardet e qeverisjes së mirë.

PPP-të në Shqipëri kanë kaluar nga një instrument i nevojshëm për investime dhe modernizim në një mekanizëm që sot shoqëria e sheh kryesisht përmes klientelizmit politik, mungesës së konkurrencës dhe vendimmarrjes së centralizuar. Në vend që të shërbejnë si mjet për të rritur efikasitetin e shërbimeve publike, shumë prej PPP-ve të zbatuara gjatë dekadës së fundit janë shoqëruar me dyshime të thella dhe evidenca konkrete që tregojnë devijimin e tyre nga standardet e qeverisjes së mirë. Kjo perceptohet sot jo vetëm nga publiku i gjerë, por edhe nga vetë institucionet ndërkombëtare që kanë paralajmëruar rreziqet fiskale të akumuluar, ndërsa FMN-ja dhe BERZH-i kanë kërkuar publikisht rishikim të kontratave problematike dhe vendosjen e një mekanizmi kontrolli mbi projektet e reja që nuk justifikojnë riskun që i kalojnë buxhetit të shtetit. Në shumë raste, detyrimet e krijuara nga PPP-të nuk pasqyrohen plotësisht në bilanci zyrtare, duke krijuar një boshllëk të rrezikshëm midis borxhit real dhe atij të raportuar, fenomen që FMN-ja e ka vlerësuar si burim kontingjencash fiskale që mund të rëndojnë financat publike për dekada.

Statistikat zyrtare të Ministrisë së Financave dhe raportet e institucioneve të pavarura tregojnë se vetëm gjatë periudhës 2014–2024, Shqipëria ka nënshkruar mbi 230 kontrata PPP me një vlerë të përgjithshme që tejkalon 2.5 miliardë euro, ndërkohë që më shumë se gjysma e tyre janë firmosur pa konkurrencë efektive. Kjo shifër nuk

## KERKO



## POSTIMET E FUNDIT

DataThon Albania 2025. Tenderat Publik dhe Persona të Ekspozuar Politikisht

PPP-të: Nga ambicia për investime te realiteti i mungesës së llogaridhënies

Përtej retorikës: Çfarë tregojnë të dhënat për PPP-të në Shqipëri?

Trajnim për OSHC Vlerësimi Parandalues për Korrupsion, bazuar në metodologjinë e miratuar dhe zbatuar në Kuvendin e Shqipërisë

pasqyron thjesht intensitetin e përdorimit të PPP-ve, por një orientim të tërë politikash që ka devijuar mënyrën si merret vendimi për investimet publike, duke e zhvendosur nga analiza e nevojave reale drejt negociatave të mbyllura dhe partneriteteve me kompani të sapokrijtura. Në terma praktikë, kjo do të thotë se për gati një dekadë, logjika e investimeve publike është drejtuar nga “urgjenca politike” dhe jo nga planifikimi afatgjatë, gjë e cila ka prodhuar projekte të shtrenjta, me kapacitete të papërdorura ose me efekte minimale në zhvillim.

Kjo dinamikë bëhet edhe më shqetësuese kur analizohen rastet konkrete. Hetimet e inceneratorëve, sot shembulli më i referuar i keqmenaxhimit të PPP-ve, ilustrojnë qartë se si kontrata shumëvjeçare, me pagesa të garantuara nga buxheti dhe me mungesë të historikut financiar të operatorëve, u shndërruan në barrë fiskale pa asnjë përfitim real për qytetarët. Raportet e KLSH-së tregojnë se në kontratën e Fierit, diferenca midis kostove të deklaruara dhe investimeve reale kapte shifra mbi 30%, ndërsa në rastin e Elbasanit, mungesa e dokumentacionit mbështetës e bëri të pamundur vlerësimin eh saktë të flukseve financiare. Edhe në sektorin e shëndetësisë, kontratat e sterilizimit dhe check-up-it kanë prodhuar një debat të thellë mbi vlerën reale të shërbimit: kostot e sterilizimit u trefishuan krahasuar me sistemin e mëparshëm, ndërsa analiza e fizibilitetit nuk përputhej me volumin real të ndërhyrjeve kirurgjikale në spitale. Kjo tregon se PPP-të, në vend që të ishin një mjet për rritje të eficiencës, u kthyen në instrumente financiare që gjenerojnë kosto të garantuara për shtetin dhe fitime të garantuara për operatorë të caktuar. Vlerësimet e pavarura të FMN-së theksojnë se shumë prej këtyre kontratave kishin transferim të pamjaftueshëm risku te sektori privat, duke lënë shtetin përgjegjës për riskun operacional dhe financiar, gjë që bie ndesh me parimet bazë të modelit PPP.

Albanian Center for Economic Research (ACER) ka qenë ndër organizatat që ka sinjalizuar me kohë problematikat strukturore: mungesën e kostimeve të detajuara, procedurat e mbyllura, negociatat pa shpallje paraprake dhe rrezikun që projektet të vendosen në funksion të interesave private dhe jo të interesit publik. Roli i ACER në nismën GO-PPP ka sjellë një analizë të re analitike, modelet ndërkombëtare të transparencës dhe rekomandime të bazuara në përvojat e mira të vendeve të tjera.

Një tjetër problematikë që shfaqet qartësisht në analizat e ACER dhe organizatave të tjera monitoruese është fakti se shumë kompani që kanë fituar kontrata të rëndësishme PPP janë regjistruar disa javë apo muaj para shpalljes së tenderit. Sipas të dhënave të QKB-së, rreth 17% e kompanive të përfshira në PPP-të kryesore të dekadës së fundit nuk kanë asnjë eksperiencë të mëparshme në sektorin përkatës, ndërsa

Detyrimet Financiare të Shtetit Shqiptar nga Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg 2015 – 2024

## ETIKETA

AIS (12)

Aranita Brahaj (13)

bashki (26)

BE (17)

Biznese (14)

Borxh (24)

Borxh Publik (15)

Buxhet (43)

Buxheti i Shtetit (29)

buxhetor (25)

covid-19 (20)

Covid 19 (13)

Durrës (12)

eksport (12)

energji elektrike (15)

Financa (23)


Gjermani (12)

import (14)

kapitali fillestar ka qenë minimal, shpesh vetëm disa mijëra euro. Këto kompani, megjithatë, kanë marrë përsipër projekte që kërkojnë dhjetëra milionë euro investime, duke ngritur dyshime të bazuara mbi financimin real dhe rrjetet e ndikimit që mundësojnë aksesin në kontrata. Në një shtet ku kapacitetet e monitorimit janë të kufizuara, mungesa e transparencës në analizat e riskut dhe fizibilitetit krijon ekosistem ideal për abuzim. Raportet e shoqërisë civile kanë evidentuar se studimet e fizibilitetit, analizat e riskut, parashikimet e të ardhurave dhe dokumentet e tjera që duhet të jenë publikisht të aksesueshme janë klasifikuar si “informacion i ndjeshëm”, duke zhveshur publikun nga e drejta për t’u informuar mbi projekte që paguhen me paratë e tij.

Kjo “kulturë” ka krijuar një fenomen të rrezikshëm: sa më pak të dihet për një kontratë, aq më e lehtë është të manipulohet. Kjo është arsyeja pse shumë prej skandaleve të viteve të fundit nuk janë zbuluar nga institucionet shtetërore, por nga gazetarët investigativ, audimet e KLSH-së dhe raportet e organizatave të pavarura. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare tregon se transparenca proaktive përfshirë publikimin e plotë të kontratave, analizave të riskut dhe vlerësimeve të pavarura ka reduktuar ndjeshëm abuzimet në vendet ku këto standarde janë zbatuar me rigorozitet.

Problemi i PPP-ve në Shqipëri nuk është vetë instrumenti, por mënyra si është përdorur: me mungesë transparence, me procedura të mbyllura dhe me konsum të lartë politik. Për të rikthyer PPP-të në shërbim të interesit publik kërkohet një ndryshim rrënjësor: publikimi i plotë i dokumenteve, vlerësim i pavarur ekonomik, konkurrencë reale dhe forcim i institucioneve të kontrollit. Në këtë mënyrë PPP mund të jenë jo një mjet për të favorizuar pakicën, por një mekanizëm modern për të përmirësuar jetën e shumicës. Evidencat tregojnë se në rastet kur PPP-të janë ndërtuar mbi baza të qarta të ndarjes së riskut, me analizë të mirëfilltë vlerës për para dhe me monitorim të pavarur, ato kanë sjellë përmirësim real të shërbimeve publike një përvojë që Shqipëria mund ta adoptojë nëse reformat strukturore zbatohen me integritet.



Përtej retorikës: Çfarë tregojnë të dhënat për PPP-të në Shqipëri?



Draft Ligji për PPP Koncesione, AIS (NGO) shpreh shqetësime mbi standardin për



AIS dhe ACER shprehin shqetësim për situatën në institucionin më të

INSTAT (17)

Itali (14)

kapital (14)

Kosovë (13)

Mali i Zi (10)

Ndiq Parate (17)

Open Corporates  
Albania (20)

OpenCorporatesAlbania  
(13)

Open Data (12)

Open Data Albania (28)

Open Procurement  
Albania (10)

Pandemi (11)

PBB (32)

PPP (23)

raporte gjinore (11)

Realizim (12)

rritje (18)

Salillari (11)

Serbi (12)

Shqipëri (41)

Shëndetësi (15)

tendera (15)

[përafrim me Direktivën EU.](#)  
[Kërkohej rishikim i thelluar.](#)

[Iartë të sektorit të prokurimit publik](#)

### Related Posts:

No related posts.

[← Përtej retorikës: Çfarë tregojnë të dhënat për PPP-të në Shqipëri?](#)

[DataThon Albania 2025. Tenderat Publik dhe Persona të Ekspozuar Politikisht →](#)

Tirana (11)

Tiranë (16)

TVSH (15)

të ardhura (29)

Vlorë (11)

### ARKIVA

Tetor 2025

Shtator 2025

Gusht 2025

Korrik 2025

Qershor 2025

Maj 2025

Prill 2025

Mars 2025

Janar 2025

Dhjetor 2024

Nëntor 2024

Tetor 2024

Shtator 2024

Gusht 2024

Korrik 2024

Qershor 2024

Maj 2024

Prill 2024

Mars 2024
Shkurt 2024
Janar 2024
Dhjetor 2023
Nëntor 2023
Tetor 2023
Shtator 2023
Gusht 2023
Korrik 2023
Qershor 2023
Maj 2023
Prill 2023
Mars 2023
Shkurt 2023
Janar 2023
Dhjetor 2022
Nëntor 2022
Tetor 2022
Shtator 2022
Gusht 2022
Korrik 2022
Qershor 2022
Maj 2022
Prill 2022
Mars 2022
Shkurt 2022

Janar 2022
Dhjetor 2021
Nëntor 2021
Tetor 2021
Shtator 2021
Gusht 2021
Korrik 2021
Qershor 2021
Maj 2021
Prill 2021
Mars 2021
Shkurt 2021
Janar 2021
Dhjetor 2020
Tetor 2020
Prill 2020
Korrik 2018
Maj 2018
Prill 2018
Mars 2018
Shkurt 2018
Janar 2018
Dhjetor 2017
Nëntor 2017
Tetor 2017
Shtator 2017

Gusht 2017
Korrik 2017
Maj 2017
Prill 2017
Mars 2017
Shkurt 2017
Janar 2017
Dhjetor 2016
Nëntor 2016
Tetor 2016
Shtator 2016
Gusht 2016
Korrik 2016
Qershor 2016
Maj 2016
Prill 2016
Mars 2016
Shkurt 2016
Janar 2016
Dhjetor 2015
Nëntor 2015
Tetor 2015
Shtator 2015
Gusht 2015
Korrik 2015
Qershor 2015

Maj 2015
Prill 2015
Mars 2015
Shkurt 2015
Janar 2015
Dhjetor 2014
Nëntor 2014
Tetor 2014
Shtator 2014
Gusht 2014
Korrik 2014
Qershor 2014
Maj 2014
Prill 2014
Mars 2014
Shkurt 2014
Janar 2014
Dhjetor 2013
Nëntor 2013
Tetor 2013
Shtator 2013
Gusht 2013
Korrik 2013
Qershor 2013
Maj 2013
Prill 2013

Mars 2013
Shkurt 2013
Janar 2013
Dhjetor 2012
Nëntor 2012
Tetor 2012
Shtator 2012
Gusht 2012
Korrik 2012
Qershor 2012
Maj 2012
Prill 2012
Mars 2012
Shkurt 2012

## RRETH NESH

[Insituti Shqiptar i Shkencave](#)

## TE DREJTAT E PERDORIMIT

Persa kohe nuk percaktohet ndryshe, i gjithe informacioni i ofruar nga Open Data Albania ofrohet nen licencat: [This material is Open Data](#)

## PROJEKTE

[Deklarime Pasurore Prokurime Transparente Open Corporates Albania Spending Data Albania Akses Info Drejtesi](#)

## KONTAKT

Rruga "Asim Vokshi"  
Nr 13 /25, Kati 3  
1001, Tirana  
[info@ais.al](mailto:info@ais.al)